

DOKUMENTAR

Pak ditë më parë, në mjediset shqiptare, u emëtua një dokumentar i ri për Martin Camajn. Duke pasur parasysh që ka pasur disa vlerësime kontradiktore në media, "Milosao" iu drejtua prof. dr. Bardhyl Demiraj, studiuesit të njohur të albanologut, i cili kumtoi disa detaje shtesë lidhur me realizimin e këtij dokumentari, duke mos munguar të mbajë qëndrim edhe ndaj disa prej komenteve që u dhanë në mediat e ndryshme për filmin në Shqipëri dhe Kosovë...

Intervistoi Ben Andoni

Premiera e këtij filmi dokumentar, të realizuar nën drejtimin e gazetares dhe regjisorës Tefta Radi, u shfaq me shumë sukses më dt. 1 nëntor në Tiranë në sallën UNESCO të Muzeut Kombëtar, duke u përsëritur me po aq sukses më dt. 2 nëntor në Shkodër në sallën e madhe të rektoratit të Universitetit "Luigj Gurakuqi", ku zonjës Erika Camaj ju dorëzua prej kryetarit të bashkisë së qytetit të Shkodrës edhe dëshmia e nderimit të Martin Camajt si "Qytetar Nderi" i Shkodrës (pas vdekjes).

Duhet sqaruar se Dega e Albanologjisë në Universitetin Ludwig-Maximilian të Munihut (LMU) së bashku me grupimin e studentëve të kësaj dege, sikurse edhe shoqata kulturore "Martin Camaj" (OJQ) në Lengrës përkujdesen në vazhdimësi për emrin dhe veprën e Martin Camajt, përkatësisht për vendin e tij në historinë e kulturës shqiptare dhe të letërësive shqiptare në mërgim gjatë gjysmës së dytë të shek. XX. Shfaqja e këtij dokumentari në Gjermani më dt. 22 nëntor në ambientet e LMU na nxiti të marrim kontakt edhe me drejtuesin e kësaj dege, prof. dr. Bardhyl Demirajn, i cili kumtoi disa detaje shtesë lidhur me realizimin e këtij dokumentari, duke mos munguar të mbajë qëndrim edhe ndaj disa komenteve që u dhanë në mediat e ndryshme në Shqipëri dhe Kosovë...

Si u prit shfaqja e këtij dokumentari në mjediset e universitetit?

"Mund të them se ishte suksesi i radhës. Kam parasysh këtu dy shfaqje e para të dokumentarit në datat 1 dhe 2 nëntor në Tiranë e në Shkodër. Shfaqjen e tij premierë në Gjermani e organizuan studentët e mi të degës së albanologjisë. Të pranishëm ishin sigurisht një numër i madh studentësh shqiptarë si edhe njohës e dashamirës të shumtë të kulturës sonë në Munihi e rrethina. Të mirëseardhur ishin me këtë rast edhe regjisorja Tefta Radi dhe operatori Agim Kuri, ndërsa vëzhguesit e rastit bënë praktikisht të pamundur praninë e gjithë ekipit dhe të aktorëve kryesorë që mundësovan realizimin e suksesshëm të këtij filmi dokumentar-biografik. Pra për shumë syresh u desh të mjaftoheshim vetëm me përshëndetjet falënderimet e njëzëshme nga larg".

Si u përfutua ky bashkëpunim me programin satelitor të RTSH?

"Si t'ju them: Nuk ishte aspak rastësi, përkundrazi finalizim i një projekti afatgjatë që zhvilloi dega jonë së bashku me studentët e Albanologjisë dhe në bashkëpunim me shoqatën "Martin Camaj" që përkujdesen në vazhdimësi për njohjen dhe përhapjen në hapësirën kompakte shqipfolëse të trashëgimisë letrare e shkencore të Martin Camajt si përfaqësues i shtresës intelektuale të mërgatës politike shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Kontakti me programin satelitor të RTSH e për më tepër me gazetarë e regjisorë cilësorë e me përvojë si zonja Radi e kushtëzuan këtë bashkëpunim, duke e shndërruar në domosdoshmëri".

Gjithsesi ky nuk ishte i pari realizim filmik për Martin Camaj, apo jo?

"Sigurisht që nuk është i pari. Lejohem të përmend sidomos programin e arritur televiziv "Barrë e vrame" (RTSH maj 1992,

E vërteta e ikjes së Camajit dhe dokumentari për të

Intervistë me drejtuesin e Degës së Albanologjisë në Universitetin Ludwig-Maximilian të Munihut (LMU), prof. Dr. Bardhyl Demirajn. Në këtë intervistë, studiuesi i njohur i albanologut, rrëfen suksesin e dokumentarit dhe ato që mund të trajtoheshin edhe ndryshe si dhe të theksoheshin, por njëkohësisht edhe përfoljet në qarqe të ndryshme sa i përket elementëve, që lidheshin me jetën e albanologut të shquar...



Bardhyl Demiraj



Martin Camaj

Ikja e Camajit

realizimi - Petro Lati dhe operator Astrit Omeri) me skenar të Ardian Klosit, njërit ndër njohësit më të mirë dhe seriozë të Martin Camajt. Prej atij realizimi është shfrytëzuar madje edhe ndonjë pasazh në këtë dokumentar. Para do muajsh pati edhe ndonjë ndërhyrje të shkurtër televizive por më së të nxituar në rubrikën "Ekskluzive" të stacionit televiziv Top-Channel, e cila u fshikullua me të drejtë, madje edhe nga njëri prej të intervistuarve, siç është rasti i kolegut dhe mikut tim, prof. Rexhep Ismajlit ("Koha Ditore": 4 nëntor 2013)".

Juve kenë qenë konsulent i këtij dokumentari. A mendoni se u arritën parimet dhe duhur në lidhje me linjën historike dhe ecurinë e veprimtarisë së tij?

"Unë shpreh bindjen se po, sidomos sa i përket njohjes dhe përditësimit të shikuesit me karrierën akademike, aktivitetin intelektual-letrar dhe angazhimin social të Martin Camajt në Romë (1956-1961) dhe në Bavari (1961-1992), ku kaloi pjesën më të frytshme të jetës së vet aktive. Ky film dokumentar hedh dritë edhe në aspekte të tjera aktivitetit shkencor-intelektual të Martin Camajt si themelues i degës universitare dhe shkencore të albanologjisë në universitetin tashmë elitari Ludwig-Maximilian të Munihut, e vetmja degë dhe qendër shkencore universitare në veri të Alpeve të Evropës që përgatiti albanologë të rinj".

Dikush mëngon të vërejtë ndërkohë edhe mungesën sa dhe si duhet në dokumentar të kontakteve të tij me kolegë dhe miq në Prishtinë e Prizren; e njëjta kritikë mund të bëhet edhe për marrëdhëniet e tij me mërgatën shqiptare në SHBA-të. Një ezaurim në detaj i të gjitha stacioneve në jetën intelektuale të Martin Camajt do të ishte edhe realisht i pamundur brenda minutazhit që lejon një film dokumentar.

Ikja e Camajit është dhe do të mbetet konfuze, sa kohë që mungon dokumentacioni i mirëfillt, ndërkohë që dëshmitarët okularë kanë ndërruar jetë ndërkohë ose janë të pайдentifikueshëm. Jemi mësuar deri sot të lexojmë e dëgjojmë variante nga më të ndryshmet lidhur me arsyet e arratisjes së Camajit, shi në vitin 1948, kur ishte i punësuar si mësues në shkollën fillore të Prekalit. I vetmi burim i besueshëm është kumtimi i agjentit të dikurshëm të CIA-s dr. Tom Koka, i cili në kujtimet e veta kumton ndër të tjera se: "...[Martini - B.D.] Ishte ma se i bindun se ne Shqiptari ishin sose ato parime, pa te sillat jeta s'ka veshtrim. Pra arseja me u largue nga vendi. Nuk u shtyena ne hollesina pse s'ishte as koha as vendi e vazhdueme ne subjekte te tjera.". Edhe pse me rolin e konsulentit në këtë dokumentar, unë vetë u befasona me variantin e paraqitur në të si të besueshëm nga një pjesëtare e re e familjes, që mëton si shkak të arratisjes detyrimin për të dorëzuar Gjon Sinishtën, një bashkënxënës në gjimnasin saverian dhe mik pas gjase i mëvonshëm i Camajit, i cili dihet ndërkohë se u arratis nga Shqipëria në vitin 1946, në moshën 17 vjeç, pra dy vjet para Camajit".

Parë pozitivisht këto vërejtje nxisin gjithsesi hetime të mëtejshme në të ardhmen".

Nuk duket pak konfuze e gjithë linja e ikjes së Camajit prej Shqipërisë?

"Përyetja është me vend. Ikja e Camajit është dhe do të mbetet konfuze, sa kohë që mungon dokumentacioni i mirëfillt, ndërkohë që dëshmitarët okularë kanë ndërruar jetë ndërkohë ose janë të pайдentifikueshëm. Jemi mësuar deri sot të lexojmë e dëgjojmë variante nga më të ndryshmet lidhur me arsyet e arratisjes së Camajit, shi në vitin 1948, kur ishte i punësuar si mësues në shkollën fillore të Prekalit. I vetmi burim i besueshëm është kumtimi i agjentit të dikurshëm të CIA-s dr. Tom Koka, i cili në kujtimet e veta kumton ndër të tjera se: "...[Martini - B.D.] Ishte ma se

i bindun se ne Shqiptari ishin sose ato parime, pa te sillat jeta s'ka veshtrim. Pra arseja me u largue nga vendi. Nuk u shtyena ne hollesina pse s'ishte as koha as vendi e vazhdueme ne subjekte te tjera.". Edhe pse me rolin e konsulentit në këtë dokumentar, unë vetë u befasona me variantin e paraqitur në të si të besueshëm nga një pjesëtare e re e familjes, që mëton si shkak të arratisjes detyrimin për të dorëzuar Gjon Sinishtën, një bashkënxënës në gjimnasin saverian dhe mik pas gjase i mëvonshëm i Camajit, i cili dihet ndërkohë se u arratis nga Shqipëria në vitin 1946, në moshën 17 vjeç, pra dy vjet para Camajit".

Paksa konfuz u paraqit në mediat edhe bashkëpunimi i Degës së Albanologjisë në LMU dhe ai i shoqatës Martin Camaj në realizimin e këtij dokumentari. A mund të thoni diçka më shumë për kontributin real të këtyre dy subjekteve?

"Këtë konfuzion të shkaktuar në mediat shqiptare e sqaroi për fat të mirë vetë regjisorja Tefta Radi, në përfundim të shfaqjes së këtij dokumentari në ambientet e universitetit tonë, ku përpos përgëzimeve fatlume u desh t'u përgjigje edhe pyetjeve të auditorit. Kontributi është më se i dukshëm, pasi ekipit xhirues ju vetëm u krijuan kushtet optimale për punën filmike në Bavari dhe Innsbruck të Austrisë, duke iu vënë në dispozicion i gjithë dokumentacioni pikant i arkivit të familjes Camaj dhe ai i dosjes Camaj në arkivin e LMU-së, por edhe punimet e mirëfillta me karakter biografik-shkencor që janë përfutur gjatë viteve në degën tonë. Pra edhe në këtë pikë gjen tumirje shprehja e "trimit të mirë me shokë shumë". Veçse rolin "e trimit" edhe në këtë rast e kreu pa dyshim realizuesja e këtij dokumentari, zonja Tefta Radi, e cila së bashku me ekipin e vet sendërtuan me sukses atë përvojë të fituar në vite. Andaj më duhet të falënderoj të gjithë edhe një herë në mbyllje të kësaj interviste".